



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot.
Dep. <u>2-0/DPK</u>	Br Prot. <u>01-995/13</u>
Dep.	Prot No
Nr.faq	Data
Broj. krahica <u>02</u>	Datum <u>04-04-2013</u>
Nr. pages	Data
	Dati
	PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **29.03.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllen rastet me Nr. AKK-03-446/13, për ztr. *Slavisa Filipovic – Zavendës Ministër në Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-446-13, për Zyrtarin e lartë, ztr. Slavisa Filipovic – Zavendës Ministër në Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, dhe njëkohësisht njëri nga personat e autorizuar të një biznesi privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-446/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari të lartë, ztr. Filipovic së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia, (DPK-01-661/2013), pas të cilës zyrtari është paraqitur ne takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të shmangur situatën e konflikti të interesit.

Zyrtari Filipovic është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, edhe pse ai biznes sipas tij është pasiv, për të vazhduar të ushtroj funksionin e tij publik pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, Zyrtari i lartë, ztr. Filipovic na Agjenci ka sjellur shkresën zyrtare (DPK/DPKI-03-869/13) nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në informata të së cilës shihet se ztr. Filipovic ka hequr dorë nga funksioni i tij Person i autorizuar i biznesit privat U.P."Pcelica" duke emruar një person të besuar në këtë funksion.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

